REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Nr.07/351/01-22242
Dt.06.11.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Këshilli i Bashkësisë Islame në Gjakovë,** për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit fetar, me destinim - Objekti i Xhamisë, me etazhitet **B+P+1**, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 nenit 21, 44 dhe 97, bien këtë:

A K T V E N D I M

I. I LEJOHET: aplikuesit: Këshilli i Bashkësisë Islame në Gjakovë, ndërtimi i objektit fetar, me destinim - Objekti i Xhamisë, sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Zhvillimor Urban dhe Vendimin për Kushte Ndërtimore, me numër 07-351/01- 13759, të datës 11.09.2017, të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale ndërtimore me numër 293/2, ZK: Jahoc, në pronësi të P.SH. "K.K.Gjakovë, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objekit është **B+P+1,** në sipërfaqe të përgjithshme (bruto) te objektit për këtë fazë: **S=917.13 m²**

Bodrumi:	**(Sip,Bruto): .....**	**S=409.79 m²**
Përdhesa:	**(Sip,Bruto): .....**	**S=428.81 m²**
Kati i parë - Galeria:	**(Sip,Bruto): .....**	**S=78.53 m²**

II. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit fetar me destinim – Objekti i Xhamisë, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja projektuese ndërtimore NPN "Real PROJECT" - Gjakovë.

III. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

IV. Investitori është i obligуar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë për Punë Inspektuese, për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit të lokacionit të piketuar.
- Për Objektet e kategorisë së dytë, Investitori duhet që për secilën fazë të ndërtimit, të parashtrojë kërkesë, pranë Drejtorisë për Punë Ispektuese, me qëllim të Inspektimit dhe përcjelljes së realizimit të punimeve nga secila fazë, si dhe kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për lëshimin e Certifikatës - Lejes së Përdorimit të objektit.

V. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

Arsyetim

Këshilli i Bashkësisë Islame në Gjakovë, me seli në rrugën "Sylejman Hadum Aga" nr.109, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM-së, me nr. 07/351/01-22242, të datës 24.10.2017 për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit fetar, me destinim - Objekti i Xhamisë, me etazhitet **B+P+1**, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 293/2, ZK: Jahoc, në pronësi të PSH "K.K. Gjakovë" siq është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:1000 , të datës 30.05.2017, i hartuar nga NSH"Geogauss"-Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 30.05.2017, në pronësi të në pronësi të PSH"K.K.Gjakovë", lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme(fotokopje) me numër të lëndës 2742/17 dt.30.05.2017, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Vendimin për Kushte Ndërtimore, me numër 07-351/01- 13759, të datës 11.09.2017, të lëshuar nga DUMM.
5. Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale Këshillit të Bashkësisë Islame, me nr. 01.Nr.011 - 37952/2015, dt.28.05.2017, nga K.K.Gjakovë.
6. Elaborati gjeolo-inxhinierik dhe gjeomekanik për ndërtimin e Xhamisë B+P+1, në lagjen Piskotë – Gjakovë, i punuar nga "NSH."Hydro Geo Burimi"-Mitrovicë.
7. Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale me nr.01nr.464-88585, dt.21.12.2015, dhe me nr,. prot.nga KBI. Nr.428/15 dt.31.12.2015.
8. Pëlqimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore me numër 08-320-01-21431, e datës 09.10.2017, nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e Komunës së Gjakovës.
9. Pëlqimin Sanitar me nr.14/530/01-21324, dt.17.10.2017, nga Inspektoriati Sanitar Komunal- Drejtoria e Inspeksionit e Komunës së Gjakovës.
10. Pëlqimin për lokacion nga mbrojtje kundër zjarrit, me nr.13/17, me datë 12.10.2017, lëshuar nga Departamenti i Parandalimit, Axhencia e Menaxhimit Emergjent, Ministria e Punëve të Brendshme, RKS.
11. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, me nr.1526, dt.19.09.2017.
12. Pëlqimin nga K.R.U. "Radoniqi" Sh.A.-Gjakovë, të datës 15.09.2017.
13. Pëlqimin nga PTK –Vala, me nr. zyrt. 43, dt.13.09.2017.
14. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, i punuar ndërmarrja projektuese ndërtimore "Real PROJECT" - Gjakovë.

I liruar nga taksa administrative, në bazë Nenit 5, parafgrafi 5.15. nën paragrafi b), të Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa nga Shërbimet Komunale, me nr. 01 Nr.011-43964/2015, dt.30.06.2015.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:
- **Investitorit,**
- **Drejtorisë së Inspekcionit ,**
- **Drejtorisë për Buxhet dhe Financa**
- **Arhivës.**

Zyrtar i lartë për çështje juridike

Zenel Shabani, jur.dipl.

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA

U. D. Drejtori

Elida Bejtullahu, inxh. e dipl.e ark.

K.K. GJAKOVË

Zona. kadastrale : Jahoc

Parcela nr.293-2

PLAN SITUACIONI





Lokacioni: Këshilli i Bashkësisë Islame - XHAMIA

Gjakovë, 06.09.2017

punoi: Fatmir Bobi, ter.gjeods.

vërtetoi: Agron Gojani, i.d.a.

30. Maj 2017 v.
Takeometri preqize
Auto CAD 2004

P = 1 : 1 000

Punoi : N.SH. "Geogauss" Gjakovë
DREJTORI
Xhelil Tertini gjeom.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGECIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT \ KOPIJA PLANA \ COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija \ Municipal Cadastral Office : GJAKOVË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona \ Cadastral Zone : JAHOC

Njësia \ Jedinica \ Unit	Tipi \ Vrsta \ Type	Sipërfaqja \ Poveršina \ Area m²
P - 70705037 - 00293 - 2	Parcelë \ Parcela \ Parcel -	4208.0



Shkalla / Razmera /Scale: 1:1000

Punoi \ Obradio \ Created :
Data \ Data \ Date : 30.05.2017
Koha \ Vreme \ Time : 13:45:17
Nënshkrimi \ Potpis \ Siganture: _____
Shënim \ Beleška \ Note :

Aprovoi \ Usvojio \ Aproved : Drejtori \ Direktor \ Director
Nënshkrimi \ Potpis \ Siganture: _____